

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024, TË STRATEGJISË PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA, MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE 2019-2024”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i këtij projektvendimi ka si qëllim miratimin e Planit të Veprimit 2022-2024, të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024, si një instrument për të mbledhur të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshtetërorë, si edhe partnerët ndërkombëtarë, në luftën kundër keqpërdorimit, zotërimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve. Ky plan veprimi synon harmonizimin e përpjekjeve të të gjithë institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese për implementimin e për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024 në një qasje ndërinstitucionale dhe ndërsektoriale, duke krijuar kuadrin e nevojshëm për bashkërendimin dhe bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve, përmes roleve e përgjegjësi të tyre. Plani Kombëtar i Veprimit është gjithashtu me rëndësi kyçe për sigurimin e mbështetjes politike dhe financiare, për zbatimin e synimeve strategjike, objektivave specifike dhe masave të përfshira në këtë plan. Në këtë plan veprimi përfshihen të gjitha aktivitetet në kuadër të projekteve të organizatave që veprojnë në fushën e armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve.

Trafikimi i armëve të zjarrit, incidentet dhe veprat kriminale të kryera me armët e zjarrit në Shqipëri mbetet ende një fenomen shqetësues, i cili mund të trajtohet vetëm në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale, ku do të përfshihet një gamë e gjerë e aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë. Një tjetër fenomen kërcënues për të ardhmen mbetet edhe shfaqja e formave të reja të trafikimit të pjesëve të armëve të zjarrit përmes kolive postare apo postës së shpejtë, tregtimit të paligjshëm online, prodhimi i pjesëve të armëve në 3D etj. të cilat kërkojnë një përgjigje ndërsektoriale dhe gjithëpërfshirëse dhe mbështesin nevojën e një kuptimi më të gjërë të qëllimeve të politikave të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024 dhe adresimin ose parandalimin në kohë të këtyre formave të reja të paligjshmërisë në fushën e AME.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Plani i Veprimit përbën dokumentin më të rëndësishëm politik dhe strategjik të vendit në fushën e kontrollit të armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave të parashikuara në Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024 dhe Planin e Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2021, por të përshtatura me dinamikën e formave të reja të shfaqjes së krimeve me armë zjarri, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj kontrollit të trafikimit të armëve zjarrit për të krijuar një platformë të mirëorientuar synimesh e objektivash strategjike në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Gjithashtu, ky projektakt është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2021, në katërmujorin III, si një nga masat për përmbushjen e detyrimeve nën kapitullin 31 në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2020-2022, ndaj miratimi i këtij projektvendimi, do të plotësojë realizimin e angazhimeve të Ministrisë së Brendshme, si në nivel kombëtar dhe ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Plani bazohet edhe në raportin e vlerësimit 3-vjeçar të Planit të Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2021 për të krijuar vijueshmëri dhe reflektuar në mënyrë adekuate masat e përcaktuara dhe ato të realizuara pjesërisht si edhe për të përfshirë dhe përpunuar masa të cilat janë raportuar të realizuara por që konsistojnë në objektiva e veprimtari të cilat janë aktuale në çdo kohë, të tilla si ndërgjegjësimi, ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, bashkërendimi i ndërhyrjeve dhe financimi i tyre i përshtatshëm. Gjithashtu, dokumenti reflekton gjetjet e rekomandimet e organizmave dhe organizatave ndërkombëtare në lidhje me situatën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve në vendin tonë si dhe rekomandimet e sugjeruara me qëllim përmirësimin e situatës.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Brendshme, vlerëson të domosdoshme miratimin e Planit të Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2021, për faktin se:

- Në kuadër të proceseve integruese të vendit tonë në Bashkimin Evropian ka akoma nevojë për plotësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor dhe

rregullator në fushën e kontrollit të armëve të vogla të lehta, municioneve dhe eksplozivëve;

- Kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, më të gjerë se forcimi i aspekteve të hetimit dhe ndjekjes penale duke zhvilluar aspektin e informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe grupeve të synuara dhe më të rrezikuara për përfshirjen e tyre në incidente dhe ngjarje me armë zjarri;
- Nevojitet të parashikohen masa parandaluese për format e reja të kërcënimeve nga keqpërdorimi, zotërimi i paligjshëm dhe trafikimi i armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve;
- Synohet përfshirja edhe e aspektit gjinor në masat për kontrollin e armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve;
- Nevojitet konsolidimi dhe rritja e kapaciteteve zbuluese në pikat kufitare për parandalimin e trafikimit të AME-ve brenda vendit dhe në drejtim të vendeve të Bashkimit Evropian;
- Synohet modernizimi i sistemeve dhe ndërlidhja e tyre duke siguruar një shkëmbim të shpejtë në kohë të informacionit me agjencitë inteligjente dhe ato të hetimit në vend por edhe me organizatat ndërkombëtare si INTERPOL, EUROPOL etj. për gjurmimin e armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, kapjen e autorëve të veprave penale të kryera me armë zjarri dhe parandalimin e akteve të dhunës apo ato me natyrë terroriste;
- Synohet gjithashtu përmbushja e rekomandimeve të progres-raporteve të Komisionit Evropian për zbatimin efektiv të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024, ngritjen e strukturave të qëndrueshme për koordinimin e aktiviteteve dhe projekteve në fushën e kontrollit të AME, por edhe rritjen e kapaciteteve analitike të njësive për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave për AME.

Plani i Veprimit 2022-2024, i propozuar për miratim, pas paraqitjes së një analize të përgjithshme mbi situatën aktuale të kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve në Shqipëri identifikon masat kryesore me qëllim rritjen e sigurisë publike në lidhje me përdorimin e armëve të zjarrit municioneve dhe eksplozivëve, krahas arritjeve të realizuara gjatë periudhës 2019-2021, në Planin e Veprimit ka parashikuar disa masa kryesore në fushat që synohet të përmirësohen gjatë zbatimit të këtij plani:

1. *Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian në fushën e AME*
 - Analiza e kuadrit ligjor aktual për prekursorët e lëndëve plasëse dhe përcaktimi i detyrimeve dhe përgjegjësive institucionale për hartimin e ligjit për tregtimin dhe përdorimin e prekursorëve me qëllim harmonizimin e

legjislacionit me Rregulloren e BE për prekursorët e eksplozivëve dhe lëndëve plasëse. Ky ligj aktualisht nuk ekziston dhe ka qënë një nga rekomandimet kryesore në takimet rajonale të Komisioneve Kombëtare të AVL me qëllim moslejimin e hapësirave për prodhimin artizanal të AME.

- Në kuadër të rishikimit të Kodit Penal janë propozuar masa për ndryshimin e dispozitave aktuale si dhe kriminalizimin e disa formave të veprave penale që përbëjnë forma të reja të kërcënimeve në fushën e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve si psh. tregtimi online i armëve të zjarrit, municioneve dhe pjesëve të tyre, si dhe pjesëve që shërbejnë për të përshtatur armët e zjarrit, printimin në 3D të pjesëve të armëve pa lejen e strukturave përkatëse. Gjithashtu janë propozuar edhe masa për kriminalizimin e mbajtjes pa leje të pjesëve të armëve të fabrikuar përmes printimit 3D ose prodhimit të tyre në mënyrë artizanale. Rishikimi i Kodit Penal synon reflektimin e risive të Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për keqpërdorimin e armëve, zotërimin e paligjshëm të armëve dhe për trafikimin e armëve. Ai është i nevojshëm edhe në lidhje me kategorizimin e armëve të zjarrit, me qëllim harmonizimin e parashikimeve të ligjit 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar për kategorinë “D” të armëve dhe parashikimeve të Kodit Penal për armët e ftohta.

2. Konsolidimi dhe rritja e kapaciteteve

- Përmirësimi i sistemeve në përdorim të Njesisë Qendrore për Armët Zjarrit (NJQAZ) si sistemet SIMA dhe IBASE, ndërlihdja mes tyre dhe mirëmbajtja.
- Sigurimi i aksesit nga Policia e Shtetit në databazën e doganave.
- Shndërrimi i NJQAZ nga një grup pune me detyra shtesë për armët e zjarrit në një strukturë të veçantë pranë Departamentit të Policisë Kriminale, si edhe një ndër rekomandimet e progres raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë në kuadër të Kapitullit 31. Ky propozim vjen edhe në kuadër të procesit të vlerësimit të nevojave të Policisë Kriminale për rritjen e efektivitetit të organizativ të saj.
- Rritja e kapaciteteve të Njesisë Qendrore për Armët Zjarrit (NJQAZ), përmes trajnimeve specifike si Anacapa, OSINT (Open Source Intelligence), Darknet dhe patrullimi kibernetik, trajnime mbi produktet e inteligjencës (Intelligence Led Policing) etj.
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për përdorimin e sistemit elektronik për sektorin e ekzaminimeve balistike në Institutin e Policisë Shkencore Tiranë, i cili do të kryejë kërkimin automatik dhe identifikimin nëpërmjet gjurmëve të formuara nga mekanizmat e armëve të zjarrit në gëzhoja dhe predha.
- Rritja e kapaciteteve dhe infrastrukturës për qentë K-9, në zbatim të aktiviteteve të projektit të OSCE për këtë qëllim.

- Rritja e kapaciteteve të policisë kufitare dhe të doganave me qëllim zbulimin e rasteve të trafikimit përfshirë edhe format e reja të trafikimit, si psh përmes kolive postare etj.
 - Ndërtimi i qendrës së çaktivizimit dhe kompletimi me pajisjet dhe materialet e duhura për kryerjen e procesit të çaktivizimit.
3. *Rritja e kapaciteteve të zbulimit dhe hetimit të rasteve të veprave penale me armë zjarri, trafikimit të armëve të zjarrit dhe rritja e bashkëpunimit mes agjencive ligjzbatuese brenda vendit dhe të huaja*
- Kontrolli dhe verifikimi i figurës (vetting) për operatorët ekonomikë, personelin (administrator, pronar, punonjës) që kanë objekt veprimtarie importimin, trazitimin dhe tregtinë e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME).
 - Mbështetja e nevojave të hetimeve online të Oficerëve të Policisë Gjyqësore, në rastet e infiltrimeve dhe blerjeve të simuluar.
 - Rritja e numrit të hetimeve proaktive me metoda speciale të hetimit duke bashkëpunuar me prokuroritë përkatëse.
 - Pjesëmarrja aktive e Policisë së Shtetit në operacionet e përbashkëta policore Joint Action Days me vendet e BE si dhe ato të rajonit.
 - Shkëmbimi i eksperiencave më të mira nëpërmjet Buletinit të Europol për Armët e Zjarrit, nëpërmjet analizave të indikatorëve të ardhura nga homologët si dhe dërgimi në Europol, i indikatorëve të riskut në rastet e evidentuara në Shqipëri.
 - Kryerja e procedurave për gjurmimin e armës nëpërmjet iARMS të Interpolit.
 - Miratimi dhe vënia në përdorim e procedurave për zbulimin, analizimin, identifikimin dhe hetimin e AME-ve, përgatitur nga SEESAC.
 - Kryerja e trajnimeve profesionale për zbulimin, analizimin, identifikimin dhe hetimin e AME-ve.
 - Forcimi i kapaciteteve logjistike të Policisë Kufitare për mbikëqyrjen e kufirit gjelbër dhe kufirit blu për zbulimin, identifikimin e AME-ve.
 - Forcimi i Kontrollit dhe parandalimi i devijimit të AME.
 - Ngritja e një mekanizmi mbikëqyrës për kontrollin e shitjes së prekursorëve, raportimi i transfertave të dyshimta dhe ndjekja në bashkëpunim me prokurorinë i të gjitha rasteve të denoncuar për dyshimet e përdorimit kriminal të prekursorëve.
 - Shkëmbimi i informacioneve policore nëpërmjet Europolit, Interpolit mbi parandalimin apo ndjekjen e mëtejshme të rasteve të trafikimit të armëve të zjarrit.

4. Shkatërrimi i tepricave të AME dhe siguria e depove të armatimit dhe dhomave të provave

- Vijimi i aktiviteteve të shkatërrimit të tepricave të AME në kuadër të rritjes së sigurisë së depove të armatimit dhe dhomave të provave.
- Kryerja e përmirësimeve të sigurisë në infrastrukturën e magazinimit në bazë të listës së kontrollit të IATG-së për forcat e armatosura dhe institucionet ligjzbatuese.
- Rinovimi i infrastrukturës së 10 ambienteve të magazinimit të AME në Policinë e Shtetit.

5. Rritja e ndërgjegjësimit për keqpërdorimin e AME dhe ulja e qarkullimit të paligjshëm të armëve të zjarrit

- Në lidhje me këto dy qëllime të politikave, është parashikuar zhvillimi i një analize të thelluar për efektivitetin e fushatave të mëparshme të dorëzimit vullnetar të armëve të zjarrit të zotëruara në mënyrë të paligjshme nga qytetarët me qëllim analizimin e situatës dhe burimit të paligjshmërisë së zotërimit të paligjshëm të armëve të zjarrit nga qytetarët para se të ndërmerret një iniciativë ligjore për dorëzimin vullnetar të tyre përmes amnistisë.

Duke miratuar këtë Plan Veprimi, të gjithë aktorët angazhohen të sigurojnë zbatimin e detyrave të përfshira në këtë dokument dhe nën përgjegjësinë e tyre përkatëse, përfshirë sigurimin e burimeve të kërkuara.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektvendimi i paraqitur është në harmoni me rendin juridik të brendshëm. Ai është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht nenin 100 të saj, në të cilin ndër të tjera përcaktohet se: “Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore”, vendimin nr. 502, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, i ndryshuar, si dhe është hartuar në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara apo konventa, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektvendim nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për fushën e rendit dhe sigurisë publike. Edhe pse projektvendimi nuk ka përafrim me *acquis communautaire* objektivat e tij dhe masat e parashikuara janë në një linjë me Udhërrëfyesin rajonal për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024", i nënshkruar në Samitin e Londrës në shkurt të 2018 dhe me objektivat e Planit të Veprimit të Bashkimit Evropian për Trafikimin e Armëve 2020-2025.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Planit të Veprimit 2022-2024, të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024 është hartuar sipas Vendimit nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)" dhe është bazuar në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, ndarë në këto qëllime të politikës:

Qëllimi i politikës 1 "Brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së, dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin" me këto objektiva specifike:

- Miratimi i kuadrit të plotë ligjor për të luftuar të gjitha format e keqpërdorimit, trafikimit dhe zotërimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) dhe harmonizimi me kuadrin ligjor të OKB-së, OSBE-së dhe BE-së.
- Përafrimi me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e kontrollit të armëve dhe në hetimet që lidhen me krimet me armë.

Qëllimi i politikës 2 "Brenda vitit 2024, të garantohet se politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në vendin tonë janë bazuar në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës" me këto objektiva specifike:

- Standardizimi dhe institucionalizimi i grumbullimit të të dhënave për armët e zjarrit sipas gjinisë dhe moshës, në lidhje me sekuestrimet e AVL-ve/armëve të zjarrit të ligjshme dhe të paligjshme, incidentet e dhunshme me armë, provat balistike dhe të dhëna të tjera që lidhen me armët e zjarrit që çojnë në analizën rajonale periodike të rrezikut për AME dhe vlerësimin e kërcënimit.
- Rritja e nivelit të koordinimit dhe monitorimi i vazhdueshëm i strategjisë dhe planit të veprimit nga Komisioni Kombëtar i AVL për të garantuar

politika efektive për parandalimin, zbutjen, reagimin dhe eliminimin e keqpërdorimit, trafikimit dhe përhapjes së paligjshme të armëve të zjarrit.

- Institucionalizimi i mbledhjes sistematike të të dhënave për drejtësinë penale dhe gjurmimit të AME.
- Integrimi i plotë i çështjeve gjinore dhe moshës në politikat për kontrollin e AVL-ve/armëve të zjarrit duke garantuar pjesëmarrjen reale të grave në kontrollin e AVL-ve /armëve të zjarrit.
- Rritja e parandalimit të keqpërdorimit të AVL/armëve të zjarrit.
- Forcimi i kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të devijimit të tregtisë së ligjshme nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve, procedurave dhe transparencës

Qëllimi i politikës 3 “Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme qarkullimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) drejt, brenda dhe përtej vendit tonë” me këto objektiva specifike:

- Garantimi i zbatimit të plotë dhe monitorimi i kuadrit ligjor, politik dhe procedural për trafikimin e AME-ve.
- Parandalimi i trafikimit (kontrabanda, tregtia dhe tranziti i paligjshëm) i AME-ve nëpërmjet proceseve dhe pajisjeve të përmirësuara dhe trajnimit të njësive të synuara ligjzbatuese.

Qëllimi i politikës 4 “Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit” me këto objektiva specifike:

- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të subjekteve të licencuara private dhe juridike për rrezikun e keqpërdorimit dhe përhapjes së paligjshme të AME-ve, përfshirë rrezikun e devijimit për prodhuesit e AME-ve.
- Zhvillimi i partneriteteve të qëndrueshme me median dhe shoqërinë civile për promovimin e kontrollit, rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut, për rrezikun e keqpërdorimit, mbajtjes së paligjshme dhe trafikimit të AME-ve.

Qëllimi i politikës 5 “Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përllogaritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në Shqipëri” me këto objektiva specifike:

- Rritja e kapaciteteve administrative dhe operacionale për sekuestrimin e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.
- Përdorimi sistematik çaktivizimi për të reduktuar zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit.

Qëllimi i politikës 6 “Në mënyrë sistematike, të ulet sasia e tepërt dhe të shkatërrohen armët e vogla dhe të lehta dhe municionet të tyre të kapura, duke respektuar standardet mjedisore” me këto objektiva specifike:

- Shkatërrimi sistematik i stoqeve të tepërta të AME-ve në një mënyrë jo të dëmshme për mjedisin.
- Shkatërrimi sistematikisht dhe publikisht i të gjitha AME-të e konfiskuara.

Qëllimi i politikës 7 “Të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve” me këto objektiva specifike:

- Garantimi i mjediseve të sigurta të magazinimit për AVL-të/armët e zjarrit dhe municionet, të projektuara sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Ngritja e kapaciteteve të subjekteve juridike përkatëse (prodhues, dyqane riparimi, dyqane shitjeje me pakicë, tregtuesit, poligonet e qitjes, poligonet e gjuetisë, shoqëritë private të sigurisë, qendrat e trajnimit) për të përcaktuar sistemet e inspektimit.

Aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit 2022-2024 kanë si synim të përmirësojnë funksionimin e sistemit gjithëpërfshirës të kontrollit të AME-ve nëpërmjet forcimit të mekanizmit të parandalimit përmes informimit dhe ndërgjegjësimit, rritjes së kapaciteteve të strukturave dhe përdorimit të informacioneve të inteligjencës, por edhe përmes identifikimit, hetimit, zbulimit dhe ndjekjes penale të autorëve të përfshirë në vepra penale të lidhura me AME. Ky plan veprimi është në përputhje me zhvillimet e fundit kombëtare dhe ndërkombëtare, kërkesat dhe detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku vendi ynë bën pjesë. Aktivitetet në këtë Plan Veprimi janë konkrete, të zbatueshme dhe të matshme, me tregues të mirëpërcaktuar.

Plani i Veprimit angazhon me detyrime një numër të gjerë institucionesh dhe agjencish shtetërore dhe jo-shtetërore, duke u bazuar në përgjegjësitë, detyrimet dhe kontributin e secilës prej tyre në parandalimin e keqpërdorimit dhe trafikimit të AME-ve. Plani i Veprimit 2022-2024 synon vijimin e bashkëveprimit të ndërsjellë të krijuar tashmë ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë dhe synon forcimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij nëpërmjet aplikimit të një politike proaktive dhe gjithëpërfshirëse. Një pjesë e mirë e aktiviteteve të iniciuara gjatë zbatimit të Planin e Veprimit 2022-2024, parashikohen të konsolidohen dhe fuqizohen më tej në Planin e Veprimit 2022-2024. Shembujt dhe praktikatat e mira janë shprehur në aktivitete konkrete dhe të matshme.

Detajimi i këtij Plani Veprimi sjell si risi, vendosjen e përgjegjësiave, marrjen e përgjegjësisë shtetërore në kostimin e aktiviteteve nga secili institucion, entitet apo strukturë dhe një qasje të integruar të institucioneve dhe agjencive shtetërore në adresimin e problematikave që lidhen me kontrollin e AME-ve.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Planit të Veprimit 2022-2024 të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024 do të zbatohet nga ministritë e linjës, institucionet e pavarura të cilat kanë një rol të veçantë në çështjet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare që operojnë në fushën e kontrollit të AME, si dhe institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

VIII. MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme. Për shkak të ekspertizës dhe përvojës në koordinimin e monitorimit të Udhërrëfyesit Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Ballkanin Perëndimor Plani i Veprimit u konsultua me ekspertët e SEESAC (Zyra e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta) në një takim me grupin ndërinstitucional të punës të zhvilluar më 14 tetor 2021 të ngarkuar me draftimin e Planit të Veprimit duke ndikuar në përmirësimin e përmbajtjes së tij.

Draft-dokumenti u dërgua për mendim (në formë elektronike) ministrive të linjës si Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Shërbimit Informativ Shtetëror.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e **Planit të Veprimit 2022-2024, të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024** është **758,959,194 Lekë**, ose **6,170,400 Euro**. Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 123 lekë për 1 Euro. Tabela 1 pasqyron kostot e përgjithshme, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 3 viteve të zbatimit të PV 2022 - 2024.

Efektet financiare janë përlllogaritur për çdo aktivitetet të Planin e Veprimit, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar për çdo aktivitet. Efektet financiare parashikohen të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të

institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e masave.

Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin e dokumenteve të tjerë kombëtarë, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2024 (faza e III), dhe propozimet sipas taveve të reja në kuadër të hartimit të PBA 2022-2024, konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e planit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit pararendës. Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Kostimi i PV është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikave së planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentet e rekomanduar nga IPSIS.

Tabela 1: Tipologjia e kostove të planit të veprimit

KOSTO KORENTE (lekë)	520,850,325	69%
KOSTO KAPITALE (lekë)	238,108,869	31%
KOSTO TOTALE (lekë)	758,959,194	100%

Tabela 2:

KOSTO TOTALE E PV (lekë)	758,959,194	100%
PBA 2022-2024 (lekë)	408,007,888	54%
FINANCIMI I HUAJ (lekë)	350,951,306	46%

Tabela 3: Burimi i financimit të planit të veprimit

	PBA 2022-2024	ASISTENCË FINANCIARE E HUAJ
KOSTO KORENTE (lekë)	382,697,888	138,152,437
KOSTO KAPITALE (lekë)	25,310,000	212,798,869
TOTALI (lekë)	408,007,888	350,951,306

Financimi i planit të veprimit do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit mbetet burimi kryesor i financimit. Për periudhën 2022-2024, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 54 % të kostove indikative dhe 46% e tij do të financohet nga donatorët. Hendeku financiar është 0%. Kostot korente zënë rreth 69% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (31%) është e parashikuar për kosto kapitale.

Disa nga projektet që do të financojnë aktivitetet janë si më poshtë:

- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat përmes Programit Global për Armët e Zjarrit

Titulli i Projektit: Përgjigja e drejtësisë penale kundër trafikimit të armëve. (50.000 USD)

- Programi për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara përmes SEESAC

Titulli i projektit: Asistencë për forcimin e luftës kundër zotërimit të paligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor. Projekt IPA rajonal ku përfituese janë 6 vendet e Ballkanit e Perëndimor. (4,996,576.88 EUR)

- Memorandum Mirëkuptimi mes OSBE dhe Ministrisë së Brendshme nr. 6149/5 dhe nr. 51 dt 05.10.2021, “ExB - Mbështetje për Rritjen e Ndërgjegjësimin për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Rritjen e Aftësive të Zbulimit nga Qentë K-9 dhe Krijimin e Kuadrit Ligjor për Çaktivizimin në Shqipëri” (1,300,000 EUR)

Për masat të planit që janë të pambuluara financiarisht për periudhën 2022-2024, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

PROPOZUESI

MINISTRI

BLEDAR ÇUÇI